



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.390/2025**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesa kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 07.02.2025, mori këtë:

## V E N D I M

Refuzohen të pa bazuara ankesat e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, Anr.390/2025, Anr.392/2025, Anr.395/2025 dhe Anr.397/2025 e datës 05.02.2025, të paraqitura ndaj subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025.

## A r s y e t i m

Më datë 05.02.2025, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.390/2025, Anr.392/2025, Anr.395/2025 dhe Anr.399/2025, nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, në të cilat pretendohet se:

-Në ankesën Anr.390/2025, pretendohet se më datë 04.02.2025 kandidati për deputet i Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës, z. Lumir Abdixhiku në tubim elektorale me qytetarë në qytetin e Lipjanit, për qëllime politike ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese ndaj kundërshtarëve politikë përkatësisht Lëvizjes Vetëvendosje! duke deklaruar me sa vijon: “Për 30 ditë fushatë nuk ofruan asgjë se nuk kanë çfarë japin, janë plot vrerë plot helm, plotë nervozizëm...”

Po ashtu i njëjti në tubimin e lartcekur Lëvizjes Vetëvendosje i referohet si "frymë populiste që për 4 vite na ndau na izoloi na mbajti të ndarë e të përçarë e na dëshmoj se nuk janë të aftë për asgjë”.

-Në ankesën Anr.392/2025, pretendohet se më datë 3 Shkurt 2025, kandidatja për deputete nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Hykmete Bajrami, me qëllim të promovimit të vetes dhe subjektit të saj politik, ka postuar në profilin e saj në facebook disa fotografi, me tekst shoqërues, ku ka përdorur gjuhë denigruese dhe urrejtëse me qëllimin dëmtues elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës duke thënë 'l ..fundi i mashtrimeve të qeveritarëve në largim.

-Në ankesën Anr.395/2025, pretendohet se më datë 04.02.2025, kandidatja për deputet i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, znj .Hykmete Bajrami në Llogarinë personale në platformën Facebook ka publikur një shkrim me përmbajtje shpifëse dhe fyese ndaj Ministrit të Ministrisë së Financave z .Hekuran Murati dhe Kryeministrit Kurti me përmbajtje si në vijim:

Më tej në ankesë theksohet se Ministri i Financave nga bisedat në Whats App, është qenka marrë me programin e LDK-së, ne do të marrim borxh sepse synojmë të ndërtojmë projekte që do t'i mbeten Kosovës për 100 vitet e ardhshme. Po, kemi 5 miliardë euro investime publike, por do të ketë projekte konkrete, si Central me gaz, linjë e gazit nëpër Kosovë, spitali i ri, fshati olimpike, infrastrukturë për kulturë, unaza e jashtme e Prishtinës dhe plot projekte të tjera.

Ne nuk pranojmë të vijmë në pozitën tënde që pas katër vitesh mandat dhe 12 miliardë euro buxhet të shpenzuar, të mos jesh në gjendje të listosh as tre projekte kapitale.

Unë edhe të mirëkuptoj ty dhe kryeministrin tënd kur dilni në foltore dhe flisni krejt përçart, sepse s'keni çfarë t'u thoni qytetarëve, as çfarë t'u premtoni, sepse s'keni përmbushur asnjë premtim, asnjë të vetëm.

-Në ankesën Anr.397/2025, pretendohet se më 04.02.2025 kandidati për deputet i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës, z.Imri Ahmeti në tubim elektoral me qytetarë në qytetin e Lipjanit, për qëllime politike ka përdorur gjuhë fyese, shpifëse dhe denigruese ndaj kundërshtarëve politik përkatësisht Lëvizjes Vetëvendosje! dhe Qeverisë së Republikës duke deklaruar me sa vijon: Qeveria qendrore na përjashtoi padrejtësisht nga investimet asnjë çerdhe asnjë rrugë asnjë investim..,"

Po ashtu i njëjti në tubimin e lartcekur ka deklaruar se: "Duhet ta themi hapur nga Qeveria qendrore kemi parë vetëm zhgënjim premtime boshe, akuza, arsyetime të kota, pa asnjë projekt madhor për qytetin dhe vendin tonë, izolim në arenën ndërkombëtare.

Përgjigje në ankesë të Subjektit Politik LDK, pretendohet se Kryetari i LDK-se z. Lumir Abdixhiku me rastin e thënies "për 30 dite fushatë nuk ofruan asgjë se nuk kane çfarë japin, janë plot vrer plot helm, plot nervozizëm " dhe "fryme populiste që për 4 vite na ndau, na izoloi, na mbajti te ndare e te përçarë, e na dëshmoj se nuk janë te afte për asgjë " nuk përben asnjë shkelje te nenit 34 paragrafi l, nënparagrafi 1.1 1 te Ligjit per Zgjedhjet e Përgjithshme.

Më tej thuhet se pretendimi se kandidatja për deputete znj. Hykmete Bajrami me rastin e postimit te saj nuk përben asnjë shkelje te nenit 34 paragrafi l , nën paragrafi 1 .1 1 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, sepse përdorimi i foljes "mashttrim" për qeveritarët e ka kuptimin e mos mbajtjes së premtimeve të dhëna gjatë fushatës elektorale.

Po ashtu pretendimi se kryetari i komunës se Lipjanit Imri Ahmeti me rastin e thënieve "Qeveria qendrore na përjashtoi padrejtësisht nga investimet, asnjë çerdhe, asnjë rruge, asnjë investim " dhe "Duhet ta themi hapur nga Qeveria qendrore kemi parë vetëm zhgënjim, premtime boshe, akuza, arsyetime te kota, pa asnjë projekt madhor për qytetin çka vendin tone, izolim ne arene ndërkombëtare " asnjë nga këto deklarata nuk përbëjnë asnjë shkelje te nenit 34 paragrafi 1 , nen paragrafi 1. 1 1 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat Anr.390/2025, Anr.392/2025, Anr.395/2025 dhe Anr.397/2025, të paraqitura me datë 05.02.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.390/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Paneli, pas shikimit të video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar shihet kandidati për kryeministër nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), në fjalimin e mbajtur në tubimet e tij gjatë fushatës zgjedhore, ku ndër të tjerash deklaroi: *“Për 30 ditë fushatë nuk ofruan asgjë se nuk kanë çfarë japin, janë plot vrerë plot helm, plotë nervozizëm...”. Poashtu në deklarimin e tij “frymë populiste që për 4 vite na ndau na izoloj na mbajti të ndarë e të përçarë e na dëshmoj se nuk janë të aftë për asgjë”. “Qeveria qendrore na përjashtoi padrejtësisht nga investimet asnjë çerdhe asnjë rrugë asnjë investim...,” dhe "Duhet ta themi hapur nga Qeveria qendrore kemi parë vetëm zhgënjim premtime boshe, akuza, arsyetime të kota, pa asnjë projekt madhor për qytetin dhe vendin tonë, izolim në arenën ndërkombëtarë”.*

Poashtu deklarimi i kandidates për deputete Hikmete Bajrami se, *“fundi i mashtrimeve të qeveritarëve në largim”*. Pretendimi se kryetari i komunës se Lipjanit Imri Ahmeti me rastin e thënieve *"Qeveria qendrore na përjashtoi padrejtësisht nga investimet, asnjë çerdhe, asnjë rruge, asnjë investim "* dhe *"Duhet ta themi hapur nga Qeveria qendrore kemi parë vetëm zhgënjim, premtime boshe, akuza, arsyetime te kota, pa asnjë projekt madhor për qytetin çka vendin tone, izolim ne arene ndërkombëtare "* sipas vlerësimit të Panelit asnjë nga këto deklarata nuk përbëjnë asnjë shkelje te nenit 34 paragrafi 1 , nen paragrafi 1. 1 1 te Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe janë në përputhje me diskursin e fushatës zgjedhore dhe i njëjti nuk ka fyer, fyer, degraduar apo urrejtje ndaj subjektit politik Vetëvendosje apo të Qeverisë së Kosovës dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me në fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: "Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: përdorimi i gjuhës, nëformën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e Cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë". Në fjalimet e lartcekura, të ofruara si prova, Paneli konstaton se nuk është përdorur gjuhë e urrejtjes, siç përcakton kjo dispozitë ligjore

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 1 17.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi I të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 390/2025 më datë 07.02.2025

**Kryesuese e Panelit**

**Arsim Hamzaj**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.